Bazuar në nenin 77-a, paragrafi 1, 2 dhe 5, neni 77-b, neni 77-v paragrafi 1, neni 77-g, neni 77-d, neni 77-gj nga Ligji për Kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 265/24, 132/25), neni 20-g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 143/19, 14/20 dhe 208/24), neni 22 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhëniet e punës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 3/06, 3/06, 44/06, 66/06, 16/07, 57/07, 77/07, 106/08, 161/08, 63/09, 114/09, 130/09, 10/10, 16/10, 50/10, 52/10, 58/10, 124/10, 132/10, 158/10, 47/11, 11/12, 39/12, 52/12, 13/13, 25/13, 54/13, 170/13, 187/13, 34/14, 106/14, 113/14, 145/14, 20/15, 33/15, 72/15, 74/15, 129/15, 167/15, 27/16, 134/16, 120/18, dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 110/19, 267/20, 151/21, 288/21, 111/21, 39/25, 74/25 dhe 124/25), Rregullores për elementet e detyrueshme të konkursit publik për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik nëpërmjet punësimit dhe të aplikacionit për punësim, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të personave të cilët kanë dhënë të dhëna të rreme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 242/24), Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit publik dhe të aplikacionit për punësim, mënyrën e zhvillimit të audicionit, si dhe mënyrën e pikëzimit në varësi të kategorisë dhe nivelit të vendit të punës për të cilin është shpallur konkursi publik në INQK "ASNOM" - Gostivar nr. 0202-102/3 dt 22.04.2026, Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në INQK "ASNOM" nr. 0101-136/3 dt 15.09.2020, ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës së INQK "ASNOM" Gostivar nr. 0101-51/4 dt 25.02.2021, 0101-8/3 dt 05.01.2022, 0101-89/2 dt 25.03.2022, 0101-236/2 dt 16.12.2022, 0101-180/3 dt 15.09.2023, 0101-67/3 dt 26.03.2025, 0101-21/8 dt 30.01.2026 dhe 0101-56/56 dt 05.03.2026, si dhe pëlqimin nga Ministria e Financave nr. 19-1957/2 dt 16.03.2026, INQK "ASNOM" Gostivar shpall:

SHPALLJE PUBLIK nr. 01/2026

për punësim në kohë të pacaktuar pune për 3 (tre) persona dhënës të shërbimeve publike në fushën e kulturës dhe 2 (dy) persona personel teknik ndihmës

INQK "ASNOM" - Gostivar shpall konkurs publik për punësim në kohë të pacaktuar pune për 3 (tre) persona dhënës të shërbimeve publike në fushën e kulturës dhe 2 (dy) persona personel teknik ndihmës, në vendet e mëposhtme të punës:

1. Vendi i punës: Ndihmës bibliotekistit, shifra KUL 03 04 GJ02 005, njësia për veprimtari bibliotekare, sektori dhënës të shërbimeve .. 3 (tre) realizues
2. Vendi i punës: Biletashitësi, shifra KUL 04 01 B01 002, njësia për personel ndihmës - teknik për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve, sektori personel teknik ndihmës/persona . ... 1 (një) reazlizues.
3. Vendi i punës: Teknik i zërit, shifra KUL 04 05 A01 003, departamenti për mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve, sektori për personel teknik ndihmës/ persona .. . 1 (një) realizues.

Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët (për vendin e punës nr.1, 2 dhe 3) janë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- të zotërojë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase
- të ketë moshë madhore
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të formës së prerë gjyqësore të mos i jetë shqiptuar dënimi i ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushtet e veçanta për vendin e punës nr. 1:

- niveli i kualifikimeve: arsim i lartë ose arsim sipëror me të paktën 180 kredi sipas ECTS ose arsim i mesëm i përfunduar (gjimnaz ose shkollë e mesme ekonomike).
- pa përvojë pune

Kushtet e veçanta për vendin e punës nr. 2:

- niveli i kualifikimeve: arsim i mesëm katërvjeçar ose arsim i mesëm trevjeçar (gjimnaz, shkollë e mesme ekonomike ose teknike)
- pa përvojë pune

Kushtet e veçanta për vendin e punës nr. 3:

- niveli i kualifikimeve: arsim i mesëm katërvjeçar ose arsim i mesëm trevjeçar (Gjimnaz ose Shkollë e mesme Teknike)
- pa përvojë pune

Orari i punës për vendet e punës nr. 1, 2 dhe 3:

- ditë pune e hënë - e premte, 40 orë pune në javë,
- orari i punës nga 08:30 deri në 16:30.

Paga neto për vendet e punës:

- Vendi i punës nr. 1: paga neto mujore 42.569 denarë,
- Vendi i punës nr. 2: paga neto mujore 36.467 denarë, dhe
- Vendi i punës nr. 3: paga neto mujore 49.101 denarë.

Kandidatët për punësim aplikojnë në konkursin publik duke plotësuar fletëparaqitjen dhe duke i bashkëngjitur prova për plotësimin e kushteve për vendin e punës. Fletëparaqitja për punësim mund të merret nga INQK “ASNOM” – Gostivar.

Kandidatët duhet t'i bashkëngjisin aplikacionit në origjinal ose të noterizuara:

- Dëshmi për shtetësi.
- Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore / Vërtetim mjekësor (jo më i vjetër se 6 muaj).
- Dëshmi se me vendim të formës së prerë gjyqësore nuk i është shqiptuar dënimi i ndalimit të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më i vjetër se 6 muaj).
- Dëshmi për arsimin e përfunduar / Diplomë për shkallën e përfunduar të arsimit.

Për vendin e punës nr. 1, shpallja publike zgjat 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin e përditshëm.
Për vendet e punës nr. 2 dhe 3, shpallja publike zgjat 3 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin e përditshëm.
Aplikacioni i plotësuar në tërësi, saktë dhe me të dhëna të sakta, së bashku me dokumentet e nevojshme, dorëzohet në arkivën e INQK "ASNOM" - Gostivar në zarf të mbyllur me shënimin: "Të mos hapet", çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në 16:00, ose me postë në adresën: IN Qendra për Kulturë "ASNOM" - Gostivar, rruga "Vëllezërit Gjinoski" pn, 1230 Gostivar, me destinacion: për konkursin nr. 01/2026.
Gjatë dorëzimit të fletëparaqitjes, personi shënon numrin e vendit të punës për të cilin aplikon. Kandidatët janë të detyruar të dorëzojnë të dhëna të sakta dhe të plota. Përzgjedhjen dhe intervistën e kandidatve të aplikuar do ta kryejë Komisioni kompetent për zhvillimin e procedurës së punësimit. Kandidatët që aplikojnë do të njoftohen në kohë për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. Aplikacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar jo në kohë, jo i plotë dhe jo i kompletuar nuk do të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni.
Procedura e përzgjedhjes për punësimin e ofruesve të shërbimeve publike përbëhet nga dy faza:
Faza 1 – Përzgjedhja administrative, e cila përfshin kontrollimin e të dhënave të futura në aplikacion me kushtet e përcaktuara në konkursin publik dhe kontrollimin e provave të bashkëngjitura në aplikacion,
Faza 2 – Intervista.
Përzgjedhja e kandidatve do të bëhet brenda afatit 45/90/120 ditë pas skadimit të afatit për aplikim, në përputhje me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhëniet e punës.
SHËNIM: Punësimet e parashikuara sipas Planit Vjetor të institucionit për vitin 2026.
Kontakt perosni: Ali Muslija, tel 070 637 220